TRE RREGULLA PËR TË SHIJUAR ADHURIMIN!

FALJA (NAMAZI) ËSHTË SHENJE BESIMI!

KUPTIMI I VETËM I FESË, ËSHTË NJOHJA E ZOTIT!

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 23 - Nr. 2 (264), Shkurt, 2025

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Ecim përpara me dritën e Zotit!

Xhamia dhe Qendra Kulturore Olikë

MYFTIU I SHKODRËS PRITI NË NJË TAKIM KORTEZIE KRYEMINISTRIN E SHQIPËRISË, SH.T.Z. EDI RAMA

ME FTESË MBRETËRORE SHEJKHU I AL-AZ'HARIT MBËRRIN NË BAHREJN

MYFTIU I SHKODRËS MORI PJESË NË PRITJEN E FESTËS KOMBËTARE TË SHTETIT TË KUVAJTIT

"RAMAZAN MUBAREK!" – SHPËRNDAHEN MATERIALET E RAMAZANIT 1446/2025

"RAMAZANI, MUAJI I RIPËRTËRITJES SHPIRTËRORE", AKTIVITET ME MOTRAT BESIMTARE

XHAMITË E SHKODRËS BËHEN GATI PËR PRITJEN E MUAJIT RAMAZAN 1446/2025

TRE RREGULLA PËR TË SHIJUAR ADHURIMIN!

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Tashmë që po na vjen edhe muaji i Madhëruar i Ramazanit, natyrshëm që gjithsecili prej nesh përpiqet të rregullojë sa të ketë mundësi me Zotin e tij, përpiqet që në komunikimin e tij me njerëzit të ruajë disa ekuilibra, të ruaj disa kufij dhe të përpiqet që botën e brendshme, dashurinë e Allahut, dashurinë e Pejgamberit (a.s), lidhjen me Kur'anin dhe praktikimin e traditës së Pejgamberit (a.s) ta dëshmojë në komunikim me të gjithë; muslimanë, jomuslimanë, me pushtet, pa pushtet, njerëz të thjeshtë, njerëz me pozitë, në mënyrë që gjithsecili prej nesh, ta dëshmojë veten si musliman i natyrshëm, pa pasur nevojë për doza artificializmi në komunikimin e tij të përditshëm.

U ndala paksa në leximet e të parëve tanë, ku gjithmonë njeriu e gjen veten të strukur në një vend të ngrohtë, ku udhëzimi, drita, dashuria e Allahut, dashuria e Pejgamberit (a.s) dhe rrezatimi i Kur'anit Famëlartë janë përherë të sigurtë.

Lexova se në shekujt e kaluar, një burrë i urtë dhe dijetar i njohur me emrin Ahmed ibn Harb thoshte: "E kam adhuruar Allahun 50 vite dhe nuk e kam gjetur ëmbëlsinë e adhurimit përderisa jam larguar nga tre gjëra: ***Kam hequr dorë nga pëlqimi i njerëzve, derisa kam arritur të them të vërtetën. Kam hequr dorë nga shoqërimi me të shthurrurit, derisa kam gjetur shoqërimin me njerëzit e mirë. Dhe e treta, kam hequr dorë nga ëmbëlsia dhe kënaqësitë e kësaj bote, derisa kam gjetur ëmbëlsinë dhe kënaqësinë e jetës së përtejme!"***

Po të ndalet gjithsecili prej nesh dhe t'i vendosë në peshoren e besimit dhe të fetarizmit të tij këto të tre rregulla, do të ndryshonte shumçka në komunikimin tonë të përditshëm me njëri-tjetrin, me njerëzit në përgjithësi, mbi të gjitha me Allahun e Madhëruar.

E para të heqim nga mendja e jonë kënaqësinë e njerëzve! A thua po e pranojnë këtë që unë po veproj, a thua do jenë të kënaqur me mua, a do më falenderojnë, a do më jenë mirënjohës, a do më shajnë, a do flasin keq kundër meje..!?

Ai që ka në horizont edhe në qendër të vëmendjes mendimin e njerëzve për të, fitimin e pëlqimit të tyre, do jetë përherë njeri i tronditur, pa bazament të shëndoshë, njeri dështak në jetë. Ndërsa ai njeri, i cili vendos para syve të tij pëlqimin e Allahut të Madhëruar, fitimin e pëlqimit të Allahut (xh. sh) nëpërmjet veprave të tij të përditshme, çfarëdo qofshin ato, do jetë njeri i suksesshëm, njeri i mbarë dhe njeri që ka përherë bekimin dhe mirësinë e Allahut të Madhëruar në jetë.

E dyta, heqja dorë nga shoqëria me njerëzit e shthurrur, që merren veç me thashetheme, që vetëm shajnë, që tërheqin drejt harameve, që tërheqin drejt vendeve e veprimeve ku nuk është pëlqimi i Allahut të Madhëruar, dhe rendja pas shoqërimit me të mirët. A nuk është thirrje e Allahut (xh.sh) në Kur'anin Famëlartë, që frikësimi Allahut të Madhëruar dhe shoqërimi në këtë botë me njerëzit e mirë, me besimtarët?! Por, kujdes kur thua me besimtarët, domethënë me njerëz elitarë, të matur në fjalën e tyre, në qëndrimin e tyre, në komunikimin e tyre, në veprën e tyre.

Dhe e treta, të heqësh nga hatri fitimin e kënaqësive të kësaj bote nepërmjet shtimit të pasurisë, nepërmjet shtimit të argëtimeve! Jo se Islami e ndalon shtimin e pasurisë, jo se Islami e ndalon punën, porse, jo të bëhet njeriu skllav i pasurisë së tij dhe i pëlqimeve të kësaj bote, sepse ngelet në klasë, humbet këtë botë dhe ahiretin. Por, të bëhet kërkues i ahiretit dhe të bëhet kërkues i asaj që vjen, duke e shfrytëzuar këtë ku është, sipas pëlqimit dhe vullnetit të Allahut të Madhëruar.

Tash që po vjen muaji i madhërueshëm i Ramazanit, besoj se të gjithë ne kemi nevojë për këto tre rregulla që të përmirësojmë përherë e më tepër, çdo ditë e më shumë marrëdhënien tonë me Zotin, si dhe marrëdhënien tonë me njëri-tjetrin. Për të kërkuar mbi të gjitha dhe përtej çdo gjëje pëlqimin e Allahut dhe kënaqësinë e Tij.

Le të flasin njerëzit çfarë të flasin, le të shkruajnë çfarë të shkruajnë, le të shajnë çfarë të shajnë; kur je razi me Allahun, dhe e ndjek dritën e udhëzimit të Tij, le të shajnë shoqëria e keqe, le të flasë kundër teje i pandershmi dhe le të shkruajë kundër teje ai që nuk beson në jetën e përtejme dhe që nuk ka lidhje me dritën e Islamit! A nuk shahet akoma sot, Pejgamberi (a.s)?! A nuk shkruhet akoma sot kundër Kur'anit?! A nuk digjet në disa vende, nga njerëz të humbur e të devijuar e zemërbosh, Kur'ani Famëlartë, fjala e Zotit?!

Prandaj, ecim përpara me dritën e Zotit dhe e presim Ramazanin inshallah, nëse kemi jetë dhe begati nga Zoti i Gjithësisë, duke u përmirësuar në mënyrë sistematike.

Allahu ju dashtë dhe ju begatoftë!

> **"Ekam adhuruar Allahun 50 vite dhe nuk e kam gjetur ëmbëlsinë e adhurimit përderisa jam larguar nga tre gjëra: Kam hequr dorë nga pëlqimi i njerëzve, derisa kam arritur të them të vërtetën. Kam hequr dorë nga shoqërimi me të shthurrurit, derisa kam gjetur shoqërimin me njerëzit e mirë. Dhe e treta, kam hequr dorë nga ëmbëlsia dhe kënaqësitë e kësaj bote, derisa kam gjetur ëmbëlsinë dhe kënaqësinë e jetës së përtejme!**

MYFTIU I SHKODRËS PRITI NË NJË TAKIM KORTEZIE KRYEMINISTRIN E SHQIPËRISË, SH.T.Z. EDI RAMA

Ditën e hënë, më 10 shkurt 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim kortezie Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z Edi Rama.

Gjatë takimit, Myftiu e informoi Kryeministrin Rama mbi historikun e Myftinisë së Shkodrës dhe faktin që viti 2025 është edhe 35 vjetori i rihapjes së xhamisë së Plumbit.

Poashtu e falënderoi Kryeministrin Rama për angazhimin e tij të madh në drejtim të rikonstruksionit dhe meremetimit të plotë të xhamisë së Plumbit, e cila pritet të inaugurohet këtë vit jubilar.

Nga ana tjetër, Kryeministri Rama shprehu kënaqësinë e tij për këtë vizitë në Shkodër, sidomos në një ditë si kjo, kur në Bashkinë e Shkodrës u bë prezantimi i dy projekt ideve të reja për zhvillimin e qendrës së qytetit të Shkodrës, e në veçanti vakëfit te xhamia "Ebu Bekër".

Myftiu dhe Kryeministri ishin të një mendimi se ky projekt-ide ka vend për ndërhyrje dhe për mendime që e përmirësojnë edhe më tepër zhvillimin e atij vakëfi në interes të Myftinisë Shkodër dhe trashëgimisë islame të qytetit të Shkodrës.

Biseda vijoi me disa çështje me interes të përbashkët, ku Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari falënderoi Kryeministrin e Shqipërisë, Z. Edi Rama për gatishmërinë për realizimin e disa prej kërkesave të kahershme të Myftinisë Shkodër në raport me vakëfet e saj, por jo vetëm.

Gjatë kësaj vizite Kryeministri Rama shoqërohej nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, Z. Benet Beci dhe Drejtori i Fondit Shqiptar për Zhvillim, Z. Dritan Agolli.

ANWAR IBRAHIM
KRYEMINISTËR I MALAJZISË

"Kjo është ajo që po ndodh sot në Palestinë!

Fuqitë koloniale përdorin forcën nën pretekstin e sigurisë, por në realitet, kjo çon në gjenocid dhe shpërngulje me forcë – dhe kjo është ajo që po ndodh sot në Palestinë!

#Al Jazeera Mubasher

ME FTESË MBRETËRORE SHEJKHU I AL-AZ'HARIT MBËRRIN NË BAHREJN

Shejkhu i Al-Az'harit mbërrin në kryeqytetin e Bahrejnit
për të marrë pjesë në Konferencën e Dialogut Islamik-Islamik

Ditën e martë, më 18 shkurt 2025, Shkëlqesia e Tij, Imami i Madh Prof. Dr. Ahmed Al-Tajjib, Sheiku i Al-Az'harit dhe Kryetari i Këshillit të Dijetarëve Muslimanë, mbërriti në kryeqytetin e Bahreinit, Manama, për të marrë pjesë në aktivitetet e Konferencës së Dialogut Islamik-Islamik, me temë "Një Komb i Bashkuar dhe një Fat i Përbashkët", që do të zhvillohet më 19 dhe 20 shkurt.

Një pritje zyrtare iu organizua menjëherë pas mbërritjes së tij në Aeroportin Ndërkombëtar të Bahrejnit, ku u prit nga Shkëlqesia e Tij, Sheiku Abdurahman ibn Muhamed ibn Rashid Al Khalifa, Kryetar i Këshillit të Lartë për Çështjet Islame, Z. Nawaf ibn Muhamed Al-Maawda, Ministër i Drejtësisë, Çështjeve Islame dhe Vakëfeve, Këshilltari Muhamed Abduselam, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Dijetarëve Muslimanë, Ambasadorja Riham Abdulhamid, Ambasadorja e Egjiptit në Mbretërinë e Bahreinit, dhe Z. Selman ibn Isa ibn Hindi Al-Manai, Guvernatori i Muharakut.

Konferenca mbahet nën kujdesin e Madhërisë së Tij, Mbretit Hamad ibn Isa Al Khalifa, Mbreti i Bahrejnit, dhe organizohet nga Al-Az'hari, Këshilli i Lartë për Çështjet Islame në Bahrejn dhe Këshilli i Dijetarëve Muslimanë.

Më shumë se 400 personalitete, përfshirë dijetarë, udhëheqës fetarë, autoritete islame, intelektualë dhe studiues nga mbarë bota, do të marrin pjesë në këtë konferencë. Ky event është përgjigje ndaj thirrjes së Shejkhut të Al-Az'harit, e cila u bë gjatë Konferencës së Dialogut Lindje-Perëndim në Bahrejn, në nëntor të vitit 2022, për të forcuar çështjet islame dhe unitetin e muslimanëve.

(officialazhareg)

MYFTIU I SHKODRËS MORI PJESË NË PRITJEN E FESTËS KOMBËTARE TË SHTETIT TË KUVAJTIT

Mbrëmjen e së mërkurë, më 19 shkurt 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mori pjesë në pritjen solemne të organizuar nga Ambasada e Shtetit të Kuvajtit në Tiranë me rastin e 64 vjetorit të Ditës së Pavarësisë dhe 34 vjetorit të Ditës së Çlirimit së Shtetit të Kuvajtit.

Në krye të herës, Myftiu Sytari uroi të Ngarkuarin me Punë të Ambasadës së Kuvajtit të Shqipëri, Sh.T.Z. Adnan Al-Ghunaim, festat kombëtare të Shtetit të Kuvajtit dhe njëkohësisht e falënderoi për kontributet e çmuara, institucionet dhe bamirësit kuvajtianë kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin në qytetin e Shkodrës dhe në mbarë trojet shqiptare.

Shteti i Kuvajtit është një vend i pasur në Gadishullin Arabik, i themeluar në vitin 1961 dhe i njohur për kontributin e tij në ndihmën humanitare dhe zhvillimin global. Përmes organizatave të ndryshme dhe fondacioneve bamirëse, Kuvajti ka ndihmuar shumë vende, përfshirë edhe Shqipërinë, në ndërtimin e shkollave, spitaleve, dhe mbështetjen e projekteve sociale dhe fetare.

Myftinia Shkodër shpreh mirënjohjen e sa të përsëritur për institucionet dhe bamirësit e shumtë të Shtetit të Kuvajtit, të cilët në këto 35 vite kanë dhënë një kontribut të çmuar në rimëkëmbjen e infrastrukturës së jetë fetare, kulturore, bamirëse dhe sociale në qytetin e Shkodrës.

FALJA (NAMAZI) ËSHTË SHENJE BESIMI!

Besimi në Zotin (xh.sh) na mëson sjelljet e mira të vetëpërmbajtjes, të drejtësisë, të nderit dhe të përgjegjësisë. Ju shikoni se çka pëson sot njerëzimi që është larguar nga besimi, gjoja në emër të përparimit e të zhvillimit!?

H. Vehbi S. Gavoçi
(1923 - 2013)

Njeriu lind, e lind së bashku me të edhe besimi në Krijuesin. Kur lexojmë librat e vjetër, shikojmë se popujt e lashtë kanë besuar e kanë pasë fé, qofshin këto të vërteta, kur besohet në një ZOT, ose të shtremba, kur adhurohen idhujt ose sende tjera të kësaj bote, si p.sh kafshë, dritë, diell, zjarr, mal, lumë, etj.

Edhe në kohët e zeza që kaluat nën thundrën e komunizmit, ju menjëherë zbuluat në zemrat tuaja ndjenjat fetare, bile disa prej jush, duke rrëzuar për tokë bustet e Enverit, hapët rrugën drejt besimit dhe ushtrimit të detyrave fetare të penguara deri në atë kohë.

Besimi në Zotin (xh.sh) na mëson sjelljet e mira të vetëpërmbajtjes, të drejtësisë, të nderit dhe të përgjegjësisë. Ju shikoni se çka pëson sot njerëzimi që është larguar nga besimi, gjoja në emër të përparimit e të zhvillimit. Ju po shikoni ose lexoni se si sillen serbët me vëllezërit e tyre të një gjuhe e të një vendi vetëm se këta janë myslimanë. Kështu ngjet edhe në vende të tjera në botë, e cila vuan nga njerëzit e larguar nga besimi.

Miliona e miliona krime ndodhin në vende të ndryshme të botës. Pse ngjasin të gjitha këto? Sepse njeriu e ka harruar besimin, e ka harruar Zotin (xh.sh) e urdhrat e Tij.

Falja (namazi) e porositë e tjera fetare formojnë folenë e më vonë edhe kullën e mirësjelljes, formojnë karakterin që e ruajnë njeriun njëlloj si e ruan ai veten nga e keqja.

Falja (namazi) është nevojë e madhe për jetën e ardhshme në të cilën secili njeri korr atë çfarë ka mbjellë në këtë jetë, e cila është shumë e shkurtë në krahasim me atë që është e përhershme.

FRYTET E FALJES (NAMAZIT) JANË TË SHUMTA

- E lidh njeriun me Zotin e vet, e shtyn për të mësuar se Zoti është me të gjithmonë, e se njeriu është nën kujdesin e nën vërejtjen e Tij të vazhdueshme.

- Përmirëson sjelljen e njeriut, sepse falja, siç e përmend vetë Zoti (xh.sh) në Kur'an: "Ndalon të zotin nga mëkatet e mëdha e gjërat e papëlqyera!"

- Të lidh me xhematin, sepse njeriu përpiqet të jetë i mirë dhe i drejtë përpara të tjerëve.

- E mëson njeriun të jetë i pastër, i rregullt dhe i përpiktë, sepse falja kërkon pastërti të madhe, ka rregulla të veçanta dhe bëhet në kohë të caktuar.

- E mëson t'u bindet më të mëdhenjve, sepse kur falet, nuk bën asgjë jashtë rregullave e veprimit që kryen Imami në falje.

- I kënaqet zemra, sepse mendon se nuk është vetëm, por është Zoti (xh.sh) përherë me të. Kush kënaqet, gëzohet e mburret më tepër se ai që ndjen nga zemra e tij se Zoti (xh.sh) është me të?

Prandaj besimtari i vërtetë, që lidhet mirë me Zotin (xh.sh), nuk i përulet askujt, nuk përzgjedh askënd për shkak të nevojave të tij apo frikës, se e din se gjithçka që ngjet e gjithçka që arrin, bëhet me dëshirën e vullnetin e Zotit (xh.sh).

PËRGËZIME PËR ATA QË KRYEJNË FALJET (NAMAZET) E DETYRUARA

Zoti (xh.sh) në Kur'anin Famëlartë thotë: "Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes se namazit!" - (Kur'ani, El-Mu'minun: 1-2)

Në Traditën Profetike ka shumë hadithe që e vlerësojnë faljen. Po sjellim disa prej tyre. "Zoti (xh.sh) na ka detyruar të falemi gjithmonë. Ai që e plotëson abdesin si duhet dhe falë vaktet në kohën e tyre të caktuar, plotëson si duhet rukunë ka premtimin nga Zoti (xh.sh), Ai t'i falë të metat, kurse ai që nuk vepron kështu nuk ka besë (Ai në se dëshiron e falë, Ai në se dëshiron e ndëshkon!" - (Transmeton Ebu Davudi, është hadith i saktë)

FALJA (NAMAZI) ËSHTË SHENJE BESIMI

Shumë ajete të Kur'anit (më shumë se 100) dhe shumë hadithe theksojnë se myslimani duhet të falet dhe të zbatojë edhe urdhrat tjera të Zotit (xh.sh) Në fillim të Kur'anit Zoti (xh.sh) duke cilësuar myslimanët thotë: "Të devotshëm janë ata që besojnë të fshehtën, e kryejnë faljen, (Namazin) dhe prej asaj që ne u kemi dhënë, ata japin zeqatë, sadaka, etj..." – (Kur'ani, El-Bekare: 3) Thotë edhe: "Në se ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë i keni vëllezërit tuaj në fé!" - (Kur'ani, Et-Teube: 11)

Edhe në kohët e zeza që kaluat nën thundrën e komunizmit, ju menjëherë zbuluat në zemrat tuaja ndjenjat fetare, bile disa prej jush, duke rrëzuar për tokë bustet e Enverit, hapët rrugën drejt besimit dhe ushtrimit të detyrave fetare të penguara deri në atë kohë.

Falja zë një vend të rëndësishëm edhe në Traditën Profetike. Shumë prej haditheve flasin për namazin, Profeti (a.s) thotë: "Ndërmjet besimtarit dhe kufrit (mosbesimit) është falja (namazi)!" - (Transmeton Muslimi) Gjithashtu në një vend tjetër thuhet: "E para gjë që pyetet njeriu në jetën e tij personale është falja (namazi) dhe në jetën shoqërore është gjaku d.m.th vrasja ose plagosja e tjetrit."

Falja (namazi) na pastron zemrën nga mëkatet, siç na pastron uji, që më të lahet njeriu pesë herë në ditë!

Marrë nga libri:
Shtyllat e Islamit - Namazi

Dr. Mustafa Mahmud

KUPTIMI I VETËM I FESË, ËSHTË NJOHJA E ZOTIT!

Miku im më tha:

Dëgjo, nëse ekziston xheneti, ashtu si ju thoni, atëherë unë do të jem i pari krejt, që do të hy në të! Sepse, unë jam shumë më fetar, se sa shumë prej pretenduesve tuaj, prej atyre që kanë mjekra dhe tesbihë në duar.

- Më fetar..? Çfarë do të thuash me këtë?

- Dua të them, se unë nuk i bëj keq askujt, nuk vjedh, nuk vras, nuk marr as nuk jap ryshfet, nuk kam smirë, nuk urrej, nuk ia dua të keqen asnjë krijese dhe nuk kam, vetëm se nijet të mirë, nuk kam për qëllim, vetëm se të dobishmen e përgjithshme... zgjohem dhe fle me ndërgjegje të qetë dhe motoja e jetës sime është të rregulloj (të bëj mirë) sa të mundem. A, nuk është kjo feja? A, nuk thoni ju, se feja është marrëdhënie e mirë?

- Kjo është diçka, që ka një emër tjetër... emri i saj është sjellje dhe rrugëtim i mirë. Kjo është prej përbërësve të fesë, por nuk është tërë feja. Ti ngatërron mes fesë dhe mes përbërësve të saj. Feja nuk ka, veçse një kuptim të vetëm, e ajo është njohja e Zotit. Ta njohësh Zotin tënd, ashtu siç duhet ta njohësh dhe mes teje dhe mes këtij Zoti të ketë sjellje dhe marrëdhënie të mirë. Ta njohësh Zotin tënd, të Madh, të Lartë, të Afërt, Përgjigjës, që dëgjon dhe shikon, që i lutesh Atij në ruku, në sexhde, me frikërespekt dhe përgjërim të robit ndaj Zotit. Kjo marrëdhënie e veçantë e jotja, mes teje dhe mes Zotit, kjo është feja. Ndërsa, sjellja e mirë e jotja me vëllezërit tuaj, ajo është prej përbërësve të këtij fetarizmi, e kjo në të vërtetën e saj është gjithashtu marrëdhënie për hir të Zotit.

I Dërguari ynë, paqja dhe bekimi qofshin me të, thotë: "Sadakaja (lëmosha) bie në dorë të Allahut, përpara se të bie në dorë të lypsarit!" - (Transmetuar nga Ibn Mes'udi)

Kështu që, kush e do Allahun, ai do edhe krijesat e Tij dhe sillet mirë ndaj tyre. Ndërsa, nëse ti e kufizon marrëdhënien tënde vetëm me njerëzit, nuk njeh, vetëm se ata dhe nuk sheh kënd tjetër, nuk sheh, vetëm se dynjanë, atëherë ti je jobesimtar komplet, edhe nëse ke rrugëtim dhe sjellje të mirë me njerëzit.

Rrugëtimi dhe sjellja jote e mirë tregojnë për zgjuarsinë, politikën, urtësinë dhe natyrën e të kuptuarit, dhe jo për fenë.

Ti dëshiron t'i fitosh njerëzit, që të kesh sukses në jetën tënde dhe rrugëtimi dhe sjellja jote e mirë është sebep (shkak) për të fituar dynjanë dhe kaq. Kjo është natyra e pjesës më të madhe të jobesimtarëve dhe shembujve tuaj.

- Më beso, nganjëherë ndjej se ekziston një fuqi.

- Fuqi!

- Po, ekziston një fuqi e panjohur pas universit. Unë besoj plotësisht, se ekziston një fuqi.

- E, cili është përfytyrimi yt për këtë fuqi? A e përfytyron atë ekzistencë, që dëgjon, shikon, mendon, i premton krijesave të Tij përkujdesje dhe udhëzim, u zbret atyre libra, dërgon për ta të dërguar dhe u përgjigjet thirrjeve dhe përgjërimeve të tyre?

- Ta them hapur, unë nuk i besoj këtyre fjalëve dhe as nuk e përfytyroj kështu, madje edhe më shumë se kaq, i shoh si tallje dhe nuk i shkon për shtat kësaj fuqie madhështore.

- Atëherë pra, ajo është fuqi elektromagnetike, e verbër, që e orienton universin drejt kotësisë, që nuk ka vlerë në të... dhe, ky është përshkrimi, i cili i shkon për shtat fuqisë tënde madhështore.

- Ndoshta.

- Sa përfytyrim të keq i ke bërë Zotit tënd! Krijoi për ty shikimin dhe e përfytyrove të verbër. Krijoi për ty udhëzimin dhe e përfytyrove të kotë, batall. Pasha Allahun, ti je tamam jobesimtar, edhe sikur të kesh tërë kohën rrugëtimin dhe sjelljen e mirë. Punët tuaja të mira, në ditën e llogarisë, do ta kenë përfundimin të pavlerë dhe do të shkërmoqen e do të bëhen pluhur.

- A, nuk është kjo zullum?

- Përkundrazi, kjo është vetë drejtësia! I ke përfytyruar këto punë, sikur pas tyre të mos kishte Udhëzues, i Cili të ka udhëzuar në këtë udhëzim, të ka udhëzuar dhe i ke bërë zullum Zotit tënd. Ke mohuar mirësinë e Tij, dhe ky është dallimi mes të mirave të besimtarit dhe të mirave të jobesimtarit, nëse të dy barazohen në rrugëtimin dhe sjelljen e mirë në pamje të dukshme. Të dy, ndoshta mund të ndërtojnë spitale për të kuruar të sëmurët. Jobesimtari thotë: Unë e kam ndërtuar këtë spital madhështor për njerëzit. Besimtari thotë: Më ka dhënë mbarësi Zoti im në ndërtimin e këtij spitali për njerëzit dhe nuk kam qenë, vetëm se ndërmjetës i kësaj të mire!

Sa dallim i madh është! Njëri ia dedikon mirësinë të zotit të mirësisë dhe nuk lë për veten e tij mirësi, vetëm thjesht ndërmjetësimin, madje deri edhe për këtë falënderon Allahun dhe thotë: Të falënderoj, o Zoti im, që më bëre sebep (shkak). Ndërsa, tjetri, mirësinë ia dedikon vetes së tij dhe vazhdon e thotë: Unë, unë, unë jam gjithçka!? Dallim i madh mes mendjemadhësisë dhe modestisë, mes kryelartësisë dhe përuljes së gjymtyrëve dhe mes plotfuqisë dhe thjeshtësisë.

Dhe, për këtë arsye, ju në fenë tuaj idhujtariste dhe në besimin tuaj të kësaj fuqie elektromagnetike të verbër, nuk faleni dhe bini në sexhde.

- E, përse të falemi dhe kujt t'i falemi? Unë nuk i shoh këtij namazit tuaj asnjë urtësi. Dhe, përse gjithë këto lëvizje, a nuk do të mjaftohej vetëm me përqendrimin?

- Urtësia e namazit qëndron në shembjen e mendjemadhësisë false, në të cilën jeton, në momentin kur bie në sexhde dhe balli yt prek dheun duke thënë me gjuhë dhe me zemër: Subhane Rabbijel-E'ala "Lavdi të qoftë Ty, o Zoti im i Lartësuar". Ti, tashmë e di vendin tënd të fundit, dhe se ti je më i ulëti, ndërsa Ai është më i Larti. Ti je dhé përmbi dhé, ndërsa Ai është i Lartësuar përmbi shtatë qiej.

Ndërsa, përse lëvizjet në namaz dhe përse nuk mjaftohemi me përqendrimin me zemër, atëherë unë po të pyes këtë radhë: Përse, atëherë, ta ka krijuar trupin dhe përse nuk mjafton me dashurinë e buzëve, por kërkon të përqafosh dhe të puthësh?

Përse nuk mjafton me bujarinë e buzëve, por bujarinë e jep me dorë dhe me pasuri. Por, Allahu ta ka krijuar trupin, nëse përqendrimi jot është i sinqertë, e ta mbulon trupin, atëherë ti bën ruku dhe sexhde, e nëse përqendrimi jot është fals (i manipuluar), atëherë ai nuk i kalon buzët tuaja.

- A, mendon se ti do të hysh në xhenet?

- Të gjithë ne do t'i afrohemi zjarrit, pastaj Allahu do t'i shpëtojë ata, të cilët ishin të përkushtuar... dhe, unë nuk e di, a kam qenë i përkushtuar apo jo? Këtë e di, i Gjithëdijshmi i të fshehtave, dhe gjithë puna ime, për fat të keq, është bojë në letër.

Ndoshta, puna është e saktë, por nuk është nijeti i saktë. Ndoshta, nijeti është i saktë, por nuk është i saktë sinqeriteti.

Mendojmë për ndonjërin prej nesh, se ai punon mirë për hir të Allahut dhe ai e punon atë për t'u dukur, për dynja dhe për prestigj mes njerëzve. Sa shumë mashtrohet me veten e tij ndonjëri prej nesh, i hyn ngatërrimi, mendimi i mirë për veten dhe kënaqësia e rreme, pa e ditur dhe pa e kuptuar... E lusim Allahun të na shpëtojë!

- A, mundet njeriu të jetë i sinqertë?

- Nuk e zotëron nga vetja e tij këtë gjë, por Allahu është Ai, i Cili i bën zemrat të sinqerta. Për këtë arsye, Kur'ani flet në shumë ajete për të sinqertët (mukhlesinë) me "e" tek l-ja dhe jo "mukhlisinë" me "i" tek l-ja . Por, Allahu ka premtuar, se: "Udhëzon drejt Tij, atë që pendohet...", pra çdokush që pendohet dhe kthehet tek Ai... Kështu që, detyrë e jotja është të kthehesh, ndërsa pjesa tjetër, i përket Atij!

Marrë nga libri:
Dialog me mikun tim ateist

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

Dr. Ali Sheriati
(1933 - 1977)

"Nëse i japim gruas të drejtat e saj njerëzore dhe islame, atëherë ne kemi përgatitur elementin më të mirë për t'u përballur me çfarëdo lloj ideologjie apo kulture kundër shoqërisë!"

NGA XHAMIA E KUÇIT, MYFTIU SYTARI: “RINIA BESIMTARE, BEKIM PËR VENDIN!”

Në kuadër të ciklit të ligjëratave javore: “Tre Muajt e Mirë dhe vlerat e besimit”, ditën e enjte, më 6 shkurt 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ligjëroi në xhaminë e fshatit Kuç.

Pas faljes së namazit të akshamit, nën drejtimin e imamit të xhamisë, H. Ferdinand Mema dhe fjalës së tij përshëndetëse, Myftiu i Shkodrës, ligjëroi rreth vlerave dhe rëndësisë që ka përmendja e Allahut në jetën e përditshme.

Myftiu bëri krahasim në mes marrëdhënies së njerëzve në përgjithësi me interesat dhe kërkesat e kësaj bote dhe shembullin e besimtarit që mbi çdo gjë në jetë, ka besimin dhe fitimin e pëlqimit të Allahut të Madhëruar.

Nëpërmjet argumenteve të ndryshme, Myftiu preku edhe temën e dhikrit, duke e trajtuar atë nga pikëpamja e ajeteve dhe shembullit të brezave të shkuar.

Myftiu solli në vëmendje të besimtarëve edhe programin ditor në adhurim e dhikër të dijetarit të madh shkodran, me famë botërore, H. Vehbi S. Gavoçi, shembulli i të cilit mbetet burim frymëzimi dhe udhëzimi për rininë në veçanti.

Myftiu theksoi se prania e të rinjve besimtarë në xhami është garanci e vazhdimësisë dhe forcimit të Islamit në trojet shqiptare, si dhe u lut për bekime e mirësi për mbarë komunitetin e fshatit Kuç, për besimtarët dhe ymetin islam, pa përjashtim.

NË XHAMINË E SHKJEZËS PËRKUJTOHET NATA E GJYSMËS SË SHABANIT!

Në vijim të ciklit të ligjëratave me temë: “Tre Muajt e Mirë dhe thirrja e besimit”, mbrëmjen e së enjtes, më 13 shkurt 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti ligjëratën e radhës në xhaminë e fshatit Shkjezë.

Në këtë mbrëmje, që përkon edhe me Natën e Gjysmës së Shabanit, Myftiu i Shkodrës uroi besimtarët e pranishëm dhe theksoi se kjo është Nata e faljes së madhe, pasi në hadithe të ndryshme transmetohet se Resulullahu (a.s) ka thënë: “Allahu i Madhëruar vështron robërit e Tij në Natën e Gjysmës së Shabanit dhe i fal të gjithë, përveç dy llojeve: atë që i bën shirk dhe ata që janë grindje!”

Nga këtu, Myftiu këshilloi besimtarët që këtë Natë ta kalojnë në adhurime e lutje, të falin e të pajtohen, t’ia bëjnë hallall njëri-tjetrit e të rinisin një faqe të re në marrëdhënien e tyre me Allahun e Madhëruar dhe me njëri-tjetrin.

Ai tha se gjëja më e mirë në këtë atmosferë të begatë, është të menduarit mirë për tjetrin, të dëshiruarit mirë për të tjerët dhe distancimi nga urrejtja, përçarja, zilia e paragjykimi.

Në fund të ligjëratës së tij, Myftiu bëri edhe një lutje me besimtarët e pranishëm dhe uroi që kjo Natë të kalohet me adhurime e lutje vullnetare deri në prag të sabahut.

Myftiu falënderoi kontributet e imamit të kësaj xhamie, H. Dritan Cukali dhe shprehu mirënjohjen e tij për këtë mexhlis të begatë.

NJOFTIM! HAPEN REGJISTRIMET PËR KURSE FETARE ONLINE!

Formular për regjistrim në Kursin Fetar Online - Myftinia Shkodër:

Sign in to Google to save your progress. Learn more

* Indicates required question

Email *

Your email

Myftinia Shkodër ka kënaqësinë të njoftojë hapjen e kurseve fetare Online, një risi kjo nga sektori i arsimit, të cilat synojnë të ofrojnë mësim dhe udhëzim fetar për të gjithë besimtarët, kryesisht për fëmijët, pavarësisht vendndodhjes së tyre në Shqipëri apo në emigracion si në Evropë, SHBA, Kanada dhe gjetkë.

Këto kurse kanë për qëllim për të përmbushur nevojat e ndryshme të komunitetit tonë dhe për të lehtësuar qasjen në dije fetare nëpërmjet platformave digjitale.

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër përmes kësaj veprimtarie digjitale inkurajon të gjithë besimtarët të përfitojnë nga kjo mundësi për të marrë dhe thelluar njohuritë e tyre fetare dhe për të forcuar lidhjen me besimin dhe moralin islam.

Jeni gati të mësoni nga komoditeti i shtëpisë suaj?

– Mësime interaktive

– Orar fleksibël (i përshtatshëm)

– Certifikatë pas përfundimit

– Mbështetje nga instruktorë me përvojë

Regjistrohu dhe përfito nga dituria dhe edukimi islam!

Për regjistrime mund të plotësoni formularin duke klikuar linkun, që gjendet në web dhe në facebook.

Për më shumë informacion ose për t’u regjistruar, na kontaktoni në email: myftinia1990shkoder@gmail.com ose na shkruani në WhatsApp, në nr. 00 355 67 455 3880.

“KALONI MË SHUMË KOHË ME FËMIJËT TUAJ”

Myftiu Sytari tërheq vëmendjen e një fenomeni tjetër që është krijimi i varësisë së fëmijëve ndaj rrjeteve sociale dhe pajisjeve elektronike, ku thekson se detyra e prindërit është të flasë me fëmijën e tij, të gjejë mënyra për të komunikuar...

Nëpërmjet një mesazhi të shpërndarë ditën e sotme, më 20 shkurt 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari trajton problematikën e marrëdhënieve ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre.

Myftiu i Shkodrës tërheq vëmendjen, se në shumë vende në Kur’anin Famëlartë përmendet thirrja: “Ja bunejja” (O biri im!).Në këtë kontekst, Myftiu Sytari sjell rastin e Hazreti Lukmanit (a.s) me të birin, Hazreti Nuhin (a.s) me të birin, Hazreti Daudin (a.s), Ibrahimin (a.s) me të birin Ismailin (a.s), etj, ku vë theksin te rëndësia që ka përkujdesja e prindit për të kaluar sa më shumë kohë me fëmijën, duke e kuptuar atë dhe duke i dhënë mundësi për t’u shprehur, duke u bërë i dashtur dhe i besueshëm për fëmijën.

Myftiu vë në dukje përhapjen e fenomenit të konsumimit të duhanit, por jo vetëm, nga moshat e reja dhe prishjen e fjalorit në komunikim, sidomos në moshat e reja, djem dhe vajza. Dhe në këtë kontekst i tërheq vëmendjen prindërve, që të jenë më të kujdesshëm me fëmijët e tyre dhe mos lejojnë që fëmijët të infektohen nga thirrje dhe ide, që i largojnë nga trashëgimia dhe tabani qytetar.

Ndërkaq, Myftiu Sytari tërheq vëmendjen e një fenomeni tjetër që është krijimi i varësisë së fëmijëve ndaj rrjeteve sociale dhe pajisjeve elektronike, ku thekson se detyra e prindërit është të flasë me fëmijën e tij, të gjejë mënyra për të komunikuar, siç Pejgamberi (a.s) në shumë vende na tregon se si komunikonte me fëmijët, duke iu referuar rastit të Hazreti Hasanit (r.a), të cilin e kishte marrë një ditë në krahë, në minberin e xhumasë, ku thoshte për të: “Ky djali im është zotëri!”.

Në fund të mesazhit, Myftiu u lut që Allahu i Madhëruar të na ruajë fëmijët tanë dhe të na bëjë ne si prind të përgjegjshëm për fëmijët tanë.

U ZHVILLUA CEREMONIA E GURTHEMELIT PËR QENDRËN KULTURORE NË MJEDË

Paraditën, e së mërkurës, më 5 shkurt 2025, në fshatin Mjedë, u zhvillua ceremonia e hedhjes së gurit të themelit për ndërtimin e Qendrës Kulturore në Mjedë, një projekt i rëndësishëm që përveç xhamisë synon të krijojë një mjedis të dedikuar për veprimtari kulturore islame dhe shoqërore në këtë zonë.

Në këtë ceremoni ishte i pranishëm edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, z. Kristian Shkreli, drejtues dhe donatorë të Shoqatës Botërore “Rahmeh” nga Kuvajti, si dhe drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, të cilët përshëndetën këtë ceremoni simbolike me rëndësi për komunitetin.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu i Shkodrës theksoi rëndësinë e ndërtimit të kësaj qendre kulturore, e cila do të shërbejë si vatër e dijes dhe frymëzim për edukimin e brezave të rinj me qëllim ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kombëtare në këtë zonë me tradita dhe taban shekullor islam.

Myftiu Sytari falënderoi donatorët dhe bamirësit nga Shteti i Kuvajtit për mbështetjen e tyre bujare në shumë fusha, si në ndërtimin e xhamive, qendrave kulturore dhe mbështetjen për projekte të ndryshme sociale, kulturore, bamirëse, etj.

Këshilltari i Përgjithshëm i Shoqatës Botërore “Rahmeh”, z. Halid El-Mul-la në emër të donatorit bamirës nga Kuvajti, shprehu kënaqësinë e tij për praninë në mesin e besimtarëve në Mjedë, si dhe kënaqësinë e madhe për pjesëmarrjen e tij në këtë ceremoni simbolike, që shënon edhe fillimin e një pune të shumëpritur, rezultatet e së cilës do të na gëzojnë të gjithëve pa masë.

Këtë ceremoni e përshëndeti edhe Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, z. Kristian Shkreli. Në fjalën e tij ai vlerësoi fillimin e punimeve për këtë qendër të re kulturore në fshatin Mjedë dhe vlerësoi realizimin e projekteve sociale dhe kulturore, që nxisin kultivimin e harmonisë dhe paqes sociale në këtë zonë.

Një fjalë përshëndetëse mbajti edhe drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, i cili në mes të tjerave falënderoi Myftininë Shkodër, kryesisht Myftiun për bashkëpunimet e dobishme ndër vite, për realizimin e shumë projekteve me vlerë për qytetin, për komunitetin mbarë dhe njerëzit në përgjithësi.

Qendra Kulturore e Mjedës pritet të shërbejë për kurse fetare dhe kulturore, si një pikë takimi për fëmijët, të rinjtë dhe komunitetin, duke ofruar aktivitete të larmishme edukuese, kulturore dhe sociale.

Ndërtimi i saj pritet të përfundojë brenda një viti, duke sjellë një kontribut të rëndësishëm në jetën shpirtërore dhe shoqërore të zonës Mjedë.

XHAMITË E SHKODRËS BËHEN GATI PËR PRITJEN E MUAJIT RAMAZAN 1446/2025



Xhamia Dërgut

Në atmosferën e begatë të ditëve të mbetura të muajit Shaban 1446 dhe në prag të muajit të madhërueshëm të Ramazanit, kur në mbarë botën islame nisin përgatitjen për pritjen e muajit të begatë të Ramazanit edhe në xhaminë e Dërgutit ka një angazhim të madh të dy imamëve, këshillit të xhamisë dhe besimtarëve për të sistemuar xhaminë, për ta pastruar dhe rregulluar atë, që të jetë sa më komode për besimtarët gjatë ditëve dhe netëve të muajit të begatë të Ramazanit.

Në këtë kontekst ka nisur puna për veshjen e ambienteve të brendshme të xhamisë, pastrimin e tapetit dhe zbukurimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme në këtë frymë të begatë që karakterizon mbarë komunitetin.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë imamët, besimtarët, bamirësit në veçanti që janë të gatshëm për të ofruar nga pasuria e tyre në të mirë të xhamive, në të mirë të shtëpive të Allahut.

Allahu i Madhëruar e begatoftë mundin dhe kontributin e kujtdo, dhe e pritshim me zemër të mirë muajin e madhërueshëm të Ramazanit.

Xhamia e "Dy Vajzave"

Ditën e diel, më 16 shkurt 2025 në ambientet e brendshme të xhamisë së "Dy Vajzave" nisi puna për sistemimin dhe rregullimin e mihrabit të xhamisë dhe lyerjen e saj.

Kjo iniciativë e Myftinisë Shkodër vjen në kuadër të prag Ramazanit të sivjetshëm me ç'rast xhamitë përgatiten me lyerje, zbukurime dhe sistemim të ambienteve të brendshme dhe të jashtme.

Në këtë kuadër, në xhaminë e "Dy Vajzave" po punohet për rregullimin dhe sistemimin e disa ambienteve, ku vëmendja është përqendruar tek mihrabi i xhamisë dhe lyerja e tij në mënyrë të veçantë.

Në trashëgiminë islame parapërgatitja për muajin e madhërueshëm të Ramazanit nis me lyerjen, sistemimin, pastrimin e oborreve, ndriçimin e xhamive, edhe si simbolikë e dritës, pastërtisë dhe bardhësisë, me të cilat karakterizohet muaji i madhërueshëm i Ramazanit.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë bamirësit dhe këshillat e xhamive, që janë të angazhuar këto ditë për të kontribuar me të gjitha mundësitë për ta pritur muajin e madhërueshëm të Ramazanit në mënyrën më të mirë të mundshme.



Xhamia e Urës së Bunës

Tradita e bukur e pastrimit, patjetër, lyerjes dhe zbukurimit të xhamive në prag të Ramazanit, është e dukshme gjithandej në xhamitë e Shkodrës, edhe në këto ditë të mbetura të muajit Shaban, në pritje të Hanës së re të Ramazanit 1446.

Edhe në xhaminë e Urës së Bunës, ka një angazhim për të lyer e pastruar, në pritje të besimtarëve frekuentues të namazeve ditore dhe adhurimeve të Muajit Ramazan.

Nën drejtimin e imamit, H. Ridvan Luzaku, këshilli i xhamisë dhe besimtarët janë angazhuar për ta pritur si duhet muajin e mëshirës dhe faljes.

Myftinia Shkodër, shpreh falënderimet dhe mirënjohjen e saj për krejt bamirësit që kontribuojnë për të mirën e xhamisë dhe jetës fetare në vend.

XHAMITË E SHKODRËS BËHEN GATI PËR PRITJEN E MUAJIT RAMAZAN 1446/2025



Xhamia Alimetaj

Fryma e begatë e parapërgatitjes për pritjen e muajti të Madhërueshëm të Ramazanit është në vetvete një mirësi e madhe nga Zoti i gjithësisë, i Cili na tërheq drejt mëshirës dhe faljes së Tij edhe nëpërmjet përgatitjes tonë për pritjen e muajit të Madhërueshëm të Ramazanit.

Gjithandej në xhami të ndryshme dhe në shtëpitë e besimtarëve shihen përgatitjet për ta pritur si duhet muajin e Begatë të mëshirës dhe faljes.

Edhe në xhaminë e fshatit Alimetaj, nën drejtimin e imamit të saj, H. Lulzim Beqiri, këshillit të xhamisë dhe besimtarëve po punohet për lyerjen, pastrimin dhe zbukurimin e xhamisë në prag të muajit të Madhërueshëm të Ramazanit.

Kjo traditë e bukur e trashëguar ndër shekuj në mesin e besimtarëve shkodranë, por jo vetëm, në prag të muajit të Madhërueshëm të Ramazanit është sinjali më i mirë për të gjithë besimtarët dhe komunitetin mbarë, që një muaj i madhërueshëm po vjen dhe siç përkujdesemi për pamjen e jashtme të xhamive tona, ashtu duhet të përkujdesemi edhe për të brendshmen e zemrave tona, dhe përgatitjen e duhur për ta pritur muajin e Madhërueshëm të Ramazanit me pendim, kthim nga dyert e Allahut (a.xh) dhe drejtim nga dashnia dhe mëshira e Tij.

Xhamia Mes-Myselim

Me një angazhim maksimal të besimtarëve, Këshillit të xhamisë dhe imamit të xhamisë së fshatit Mes-Myselim, përfundon edhe java e fundit e muajit Shaban për këtë vit, duke lajmëruar afrimin e Muajit të shumëpritur për të gjithë besimtarët anembanë botës.

Sistemimi i oborrit, mbjellja e pemëve të Ramazanit, lyerja dhe pastrimi, ishin kryefjalë e sa e sa ditëve, për rininë dhe frekuentuesit besnikë të kësaj xhamie me traditë, në fshatin e dëshmuar për vlerat islame ndër shekuj.

Tashmë, me ardhjen e Muajit Ramazan 1446, xhamia e Mes-Myselimit do të rrezatojë shembullin e rinisë besimtare, aktivistëve të zellshëm, këshillit të lidhur në vepra të hajrit dhe imamit të përkushtuar.

Myftinia Shkodër, shpreh mirënjohjen më të thellë për këtë model, që i shtohet hartës së dritshme të gjallërimit të xhamive tona në prag të Muajit të bekimeve!

Xhamia Trush

Në këto ditë të begata të Muajit Shaban, ku besimtarët përgatiten për të hyrë në atmosferën shpirtërore të Muajit Ramazan, në të gjitha xhamitë e botës islame nisin përgatitjet për pritjen e Mikut të Madh!

Edhe në vendin tonë, nëpërmjet aktiviteteve, fushatave bamirëse dhe kontributeve të shumta të besimtarëve, xhami të ndryshme meremetohen, lyhen e zbukurohen, ndërrojnë tapetat e bëhen gati në çdo aspekt, që Muaji Ramazan të na gjejë ndryshe!

Edhe në xhaminë e fshatit Trush, besimtarët e të cilit, japin vazhdimisht për mirëmbajtjen e xhamisë, kjo frymë ka ardhur me begati e plot mirësi.

Nën drejtimin e imamit, H. Jetmir Braqi, këto ditë po bëhen punime për meremetimin, lyerjen, pastrimin e përgjithshëm dhe përgatitjet e duhura në prag të Natës së Gjysmës së Shabanit dhe mbërritjes së shumëpritur të Muajit Ramazan.

Myftinia Shkodër, shpreh falënderimet dhe përkrahjen e saj për këto nisma dhe ndërmarrje me dobi për komunitetin dhe shembullin e mirë që ato përcjellin për këdo.

PËRUROHET QENDRA KULTURORE OBLIKË

Paradrekën e së mërkurës, më 5 shkurt 2025, Myftinia Shkodër organizoi përmes një ceremonie përurimin e Qendrës së re Kulturore Oblikë, e financuar nga bamirës të Shtetit të Kuvajtit dhe ndërtuar nga Fondacioni "Mirësia".

Me pjesëmarrjen e besimtarëve të zonës Ana e Malit dhe të shumë nxënësve të kësaj qendre, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi vëllezërit nga Kuvajti, ndërsa nënvizoi se projekte të tilla shërbejnë në gjallërimin e jetës fetare, sociale dhe jo vetëm në zonën e Shkodrës: "Elhamdulilah që e mbërritëm këtë ditë të bekuar për t'u mbledhur për këtë event. Për hir të së vërtetës e kam diskutuar disa herë me vëllain tim, Korab Kaja, drejtorin e Fondacionit "Mirësia", se kur do ta organizojmë momentin e inaugurimit të kësaj Qendre, e cila i ka dhënë frytet e saj dhe vazhdon të punojë në mënyrë sistematike, të mrekullueshme dhe shembullore.

Desht Allahu (xh.sh), që miku im i shtrenjtë dhe i dashur, profesor Halidi nga "Rahmeh Alemiyeh", së bashku me vëllezërit e tij që punojnë në këtë Fondacion ndërkombëtar në Shtetin e Kuvajtit, të na urdhëronin sot në Shkodër dhe bashkërisht ta nisnim ditën me inaugurimin e gurëthemelit të Qendrës Kulturore në Mjedë, te xhamia e Mjedës.

Pas atij gëzimi që përjetuam atje erdhëm këtu për të prerë shiritin e Qendrës Kulturore të Oblikës. Me mbarësinë e Allahut (xh.sh) ky rrugëtim që ne kemi bashkërisht me Fondacionin "Mirësia" dhe me vëllezërit e "Rahmeh Alemiyeh", në Shtetin e Kuvajtit, do të vazhdojë me projekte të tjera, që i shërbejnë më së miri gjallërimit të jetës fetare, shoqërore, por jo vetëm, në zonën e Shkodrës".

Zv. drejtori i Shoqatës Botërore "Rahmeh" në Kuvajt, Dr. Adnan El-Hadad si dhe drejtori i Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja falënderuan Myftininë Shkodër për bashkëpunimin dhe mundësinë për të ofruar këtë qendër kulturore dhe edukuese për fëmijët dhe të rinjtë e kësaj zone.

Dr. Al-Hadad theksoi ndër të tjera se: "Shoqata 'Rahmeh Alemiyeh' nga Shteti i Kuvajtit punon afërsisht mbi 40 vjet në Kuvajt dhe e ka shtrirë aktivitetin në më shumë se 40 shtete në mbarë botën. Është mirësi nga Allahu (xh.sh), që aktiviteti ynë në Shqipëri vazhdon që prej 20 vitesh.

Ceremonia u përshëndet edhe nga z. Korab Kaja, drejtor i Fondacionit "Mirësia".



Në fjalën e tij, shprehu falënderimet për këtë bashkëpunim me Myftininë e Shkodrës, si dhe kënaqësinë e madhe të rezultateve të dukshme të punës në këtë qendër, gjë që dëshmohet edhe nga prania e grupeve të ndryshme rinore që e frekuentojnë atë.

Pas prerjes së shiritit, të pranishmit në këtë ceremoni vizituan ambientet e bukura të Qendrës si dhe shijuan koktejlin e përgatitur nga nxënësit e kësaj Qendre, nën drejtimin e mësueses së përkushtuar, znj. Kimete Elezi.

Në fund të ceremonisë, Myftiu i Shkodrës, në emër të Myftinisë i dorëzoi një Certifikatë Mirënjohjeje Shoqatës nga Kuvajti në shenjë falënderimi për të gjithë kontributin e dhënë ndër vite në Shqipëri, në veçanti në zonën e Shkodrës.

DOLI NË QARKULLIM BULETINI VJETOR NR. 14, PËR VITIN 2023

Myftinia Shkodër ka nxjerrë në qarkullim buletinin e saj vjetor, Nr. 14 një përmbledhje e aktiviteteve të larmishme, vizitave dhe të vizitorëve, takimeve dhe veprimtaritë arsimore të mejtepeve fetare të zhvilluara gjatë vitit 2023.

Ky botim shërben si një pasqyrë e angazhimit të institucionit të Myftinisë Shkodër në jetën fetare, sociale dhe kulturore të zonës Shkodër.

Gjithashtu, buletini përfshin edhe detaje mbi vizitat dhe bashkëpunimet me institucione të ndryshme vendase e të huaja, mesazhe, promocione mediatike, aktivitete bamirëse, emisionet audiovizive në radio dhe televizione lokale dhe kombëtare, bashkëpunimet me shoqatat dhe qendrat islame, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e xhamive, trajtesat e çështjeve të vakëfeve dhe menaxhimin e tyre, si dhe mbi takimet me të rinjtë dhe besimtarët për çështje të ndryshme të jetës fetare dhe sociale.



Ky publikim synon të informojë komunitetin shkodranë dhe më gjerë mbi punën dhe shërbimet e Myftinisë Shkodër, si dhe të ofrojë një pasqyrë të aktiviteteve të realizuara gjatë vitit të 2023.

Buletini që është botuar nën kujdesin e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe të redaksisë e përbërë nga teologët Lavdrim Hamja dhe Arben Halluni është tashmë i disponueshëm për të gjithë të interesuarit në zyrën e institucionit.

EKSKURSION NË TIRANË ME FËMIJËT E MEJTEPIT FETAR TË XHAMISË KULLAJ, POSTRIBË

Myftinia Shkodër, me anë të sektorit të arsimit, ditën e shtunë, më 15 shkurt 2025, organizoi një ekskursion dhe shëtitje në Tiranë me fëmijët e kursit/mejtepit fetar të xhamisë Kullaj, Postribë nën moton: "Të mësojmë dhe të argëtohemi", me qëllim njohjen dhe afrimin e tyre me historinë dhe vlerat fetare islame të kryeqytetit.

Përpara nisjes, fëmijët u përshëndetën nga përgjegjësi i arsimit në Myftininë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili i ftoi ata për të përfituar sa më shumë nga ky udhëtim, si në aspektin kulturor ashtu edhe atë shpirtëror.

Gjatë ekskursionit, nën kujdesin e imamit dhe mësuesit të tyre, H. Ardin Selhani ata vizituan disa prej xhamive më të rëndësishme të Tiranës, si xhaminë e madhe Namazgja dhe xhaminë shekullore Ethem Beu, ku mësuan rreth historisë dhe rolit të tyre, që kanë luajtur në jetën fetare dhe shoqërore të vendit. Fëmijët patën mundësinë të dëgjojnë shpjegime nga imamët dhe të bëjnë pyetje të ndryshme, për të cilat morën përgjigjet përkatëse.

Përveç vizitave në xhami, grupi i nivelit të parë të nxënësve shfrytëzoi rastin për të shëtitur në disa pika historike dhe kulturore të Tiranës, duke e bërë këtë ekskursion një përvojë të vlefshme edukative dhe shpirtërore.

Ky aktivitet është pjesë e angazhimit të Myftinisë Shkodër për të forcuar lidhjen e brezit të ri me vlerat fetare dhe traditat islame dhe kombëtare.

MYFTIU I SHKODRËS LIGJËRON NË DINOSHË TË MALIT TË ZI

Ditën e diel, më 16 shkurt 2025, me ftesë të Këshillit të Bashkësisë Islame në Dinoshë të Malit të Zi, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mori pjesë në aktivitetin që zhvilloi KBI Dinoshë në prag të muajit të madhërueshëm të Ramazanit.

Në pritje të Myftiut të Shkodrës ishin kryeimami i Dinoshës, H. Xhevahir ef. Arifaj, kryetari i Këshillit të xhamisë Dinoshë, z. Shemsudin Luani dhe imami i xhamisë Msc. Nadir ef. Bajraktari, të cilët i uruan mirëseardhjen dhe bashkërisht me xhematin e pranishëm falën namazin e jacisë.

Më pas, gjatë ligjëratës së tij, Myftiu i Shkodrës u ndal në rëndësinë që ka parapërgatitja e besimtarit për pritjen si duhet të muajit të madhërueshëm të Ramazanit, duke e konsideruar atë një mik të veçantë dhe me shumë rëndësi që vjen një herë në vit si një bekim i madh nga Zoti i gjithësisë për krejt ymetin islam dhe mbarë njerëzimin.

Nëpërmjet argumenteve të shumta kur'anore, hadithet dhe trashëgimia islame, Myftiu Sytari përcolli disa mesazhe me dobi, të cilat u mirëpritën nga besimtarët e pranishëm në këtë mexhlis të begatë.

Aktiviteti vazhdoi edhe me ndejën pas tubimit në xhami, ku Myftiu iu përgjigj pyetjeve të shumta të pranishmëve në një bashkëbisedim të ngrohtë dhe vëllazëror me vlera islame dhe kombëtare.

NIS LYERJA E KANGJELLAVE TË XHAMISË SË FUSHË ÇELËS

Nga minberi i xhamisë së Fushë Çelës, "Ebu Bekër", Myftu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari lajmëroi besimtarët se në fundjavë do të nisë puna për lyerjen e kangjellave të xhamisë.

Pikërisht sot, ditën e diel, më 16 shkurt 2025, në kuadër të përgatitjeve për muajin e begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër, filloi punën për lyerjen dhe pastrimin e kangjellave të xhamisë "Ebu Bekër", me ç'rast Myftiu i Shkodrës dha edhe një mesazh për mediat e pranishme, ku vuri theksin tek simbolika e bardhësisë që ka muaji i madhërueshëm i Ramazanit dhe rëndësia që ka përcjellja e mesazheve të parapërgatitjes për muajin e Ramazanit që njerëzit të angazhohen me pastrimin e shtëpive, pastrimin e oborreve, ndriçimin e tyre dhe ndriçimin e shtëpive, si një traditë shekullore islame, në pritje të këtij miku të madh që vjen për mbarë njerëzimin.

Këto ndërhyrje synojnë përmirësimin dhe mirëmbajtjen e xhamive dhe sinjalizimin e ardhjes së Muajit të bekimeve!

Myftiu i Shkodrës i dha përgjigje edhe pyetjes së një gazetari lidhur me projektin e zhvillimit të vakëfit pranë Xhamisë së Madhe, një ide e prezantuar para pak ditëve nga Kryeministri i Shqipërisë dhe Bashkia e Shkodrës, të cilët i falënderoi për vullnetin dhe qëllimin e mirë në interes të përfshirjes së vakëfit në listën e hapësirave për zhvillim.

Myftiu theksoi se ajo që është prezantuar është thjeshtë një projekt-ide e pa pleqnuar me detaje me Myftininë Shkodër, që është pronare legjitime dhe pa u përputhur me filozofinë e arkitekturës islame dhe frymën e trashëgimisë osmane e islame të Shkodrës, asnjë projekt-ide nuk mund të marrë miratimin e Myftinisë Shkodër.

PËRGATITUNI PËR RAMAZAN ME PENDIM DHE KTHIM TEK ALLAHU!

Në vijim të ciklit të ligjëratave me temë: "Tre Muajt e Mirë dhe thirrja e besimit", mbrëmjen e së enjtes, më 20 shkurt 2025, në vend të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, për shkak të një udhëtimi të paplanifikuar, ligjëratën e kësaj mbrëmjeje, në xhaminë e fshatit Shtuf, e mbajti teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së "Dy Vajzave".

Në ligjëratën e tij, teologu Hamja u ndal te rëndësia e kthimit tek Allahu i Madhëruar si parapërgatitje e pritje së muajit të Begatë të Ramazanit. Ai theksoi se pendimi është një cilësi e lartë e besimtarëve dhe prej mëshirës së Allahut është se, kur robi pendohet dhe kthehet te Zoti i tij, edhe gabimet ia kthen në vepra të mira.

Këtë e vërteton më së miri ajeti kur'anor, kur Zoti i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: "Përveç atij që pendohet, beson dhe bën vepra të mira, të tillëve, Allahu ua kthen të këqija e tyre në të mira. Me të vërtetë Allahu është Falës, Mëshirues!" – (Kur'ani, El-Furkan: 70)

Më tej, imami i nderuar solli shembuj të ndryshëm të pendimeve nga Kur'ani Famëlartë, hadithet e Pejgamberit (a.s) dhe nga brezat e parë, të cilët me pendimin e tyre janë kthyer në njerëz të devotshëm dhe të përkushtuar, përmes adhurimit dhe veprave të mira.

Teologu Hamja falënderoi imamin e xhamisë së fshatit Shtuf, H. Fehmi Dushku për angazhimin dhe shërbimet e tij në këtë xhami, si dhe besimtarët e saj të përkushtuar, të cilët e mirëmbajnë dhe përkujdesen për të.

Cikli: "Tre Muajt e Mirë dhe thirrja e besimit" do të vazhdojë me ligjëratën e radhës në xhaminë e fshatit Mëlgushë, ditën e enjte, më 27 shkurt 2025.

"RAMAZANI, MUAJI I RIPËRTËRITJES SHPIRTËRORE", AKTIVITET ME MOTRAT BESIMTARE

Paraditën e të shtunës, më 22 shkurt 2025, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare për motrat besimtare me titull: " Ramazani, muaji i ripërtëritjes shpirtërore", si një buqetë emocionesh në prag Ramazani".

Ky aktivitet i dha jehonë fillimit të muajit të Madhëruar të Ramazanit, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë e frymëzuese, si dhe emocione të përzemërta nga të pranishmet, të cilat kishin mbushur plot sallën.

Programi i këtij aktiviteti ishte ndërthurur me ligjërata të mbajtura nga profesoreshat e nderuara, si dhe lexim të Kur'anit Famëlartë, ilahi të ndryshme dhe poezi, që u përcollën me mjeshtëri nga grupi i fëmijëve dhe vajzat e reja.

Temat e kumtuara në këtë aktivitet ishin: "Agjërimi i Ramazanit mes tradicionales dhe dinamikave te reja" – teologia MSc. Jetmira Plaku; "Agjërimi dhe ndikimi i tij në shëndetin mendor" – pedagogia e psikologjisë Dr. Jonida Lesha, dhe "Si t'i shmangim shpërqendrimet gjatë Ramazanit" – teologia MSc. Zamira Bushati.

Këto ligjërata trokitën në çdo mendje e zemër, për të hapur dyert për mysafirin e begatë, muajin e shenjtë të Ramazanit.

Myftinia Shkodër ju uron: "Me zemër të mirë Muajin Ramazan!"

“RAMAZANI, FTESË E PËRJETSHME!”, TRIBUNË FETARE NË PRAG TË RAMAZANIT

Ditën e shtunë pas akshamit, më 22 shkurt 2025, në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të rinisë organizoi tribunën fetare me temë: “Ramazani, ftesë e përjetshme!”.

Aktiviteti filloi me leximin e ajeteve të agjërimit nga H. Durim Kasemi dhe pastaj përshëndeti teologu Ervil Kuçi, përgjegjës i sektorit të rinisë, pranë Myftinisë Shkodër.

Teologu Kuçi pasi përshëndeti të pranishmit dhe i uroi të ftuarit mirëseardhjen të ftuarit special të kësaj mbrëmjeje, u ndal te mirësia e Ramazanit, si një ftesë, e cila përsëritet çdo vit nga Zoti i gjithësisë për të gjithë besimtarët, që ta shfrytëzojnë këtë muaj të begatë me adhurime dhe veprat të mira, dhe t’i përgjigjen kësaj ftese bujare të Zotit të Madhëruar.

Më pas, fjalën e mori i ftuari special i kësaj tribune, H. Vladimir Kera, i cili vuri theksin te rëndësia dhe vlera e madhe që ka agjërimi, si dhe ndikimi i tij në jetën shpirtërore dhe psikologjike tek agjëruesi. Ndër të tjera, ai tha, se: “Kur’ani Famëlartë mbetet libri i vetëm, të cilin ne si besimtarë duhet ta kemi referencën tonë kryesore, nga i cili ne ndërtojmë të gjithë pikëpamjen tonë fetare”.



Në vazhdim teologu Kera shpjegoi në mënyrë shkencore dhe të qartë ndikimin e agjërimit dhe vlerën e dobinë e tij në jetën e njeriut dhe në sjelljet e tij.

Ligjëratë u ndoq me vëmendjen nga të pranishmit dhe gjithashtu u transmetuar live në profilin e Myftinisë Shkodër.

TAKIM ME IMAMËT DHE MUEZINËT NË PRAG TË MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT 1446/2025

Ditën e hënë, më 24 shkurt 2025, në xhaminë e “Dy vajzave”, pas faljes së namazit të iqindisë, Myftinia Shkodër organizoi takimin tradicional me imamët e xhamive dhe muezinët për të dhënë udhëzimet përkatëse për mbarëvajtjen e të gjitha aktiviteteve dhe riteve fetare gjatë muajit të Begatë të Ramazanit në xhamitë e Shkodrës.

Fillimisht, teologu Arben Halluni në fjalën e tij, prezantoi plan-programin e Myftinisë për zhvillimin e aktiviteteve të larmishme kulturore, arsimore, mediatike, sociale, humanitare etj, të cilat kanë nisur në prag të Ramazanit dhe do të kulmojnë gjatë këtij muajit të madhëruar.

Më pas e mori fjalën H. Lavdrim Hamja, i cili paraqiti udhëzimet e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mbi rëndësinë e ruajtjes së traditave dhe vlerave unike në mesin e besimtarëve, angazhimin e imamëve në gjallërimin e jetës fetare, sidomos gjatë muajit të Begatë të Ramazanit si dhe udhëzime të tjera.

Në fund të takimit, u shpërndanë baza materiale si: udhëzimet e Ramazanit, kalendarë, postera, etj.

MBYLLET CIKLI I LIGJËRATAVE: TRE MUAJT E MIRË DHE THIRRJA E BESIMIT!

Ditën e enjte, më 27 shkurt 2025, në xhaminë e fshatit Mëlgushë u mbajt ligjërata e radhës e ciklit: Tre muajt e mirë dhe thirrja e besimit!

Pas namazit të akshamit të drejtuar nga imami i xhamisë, H. Elsamet Muhja, ligjëratën e rastin e mbajti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili shprehu kënaqësinë e tij për realizimin e këtij projekti të dobishëm, të shpërndarë në shtatë javë në xhami të ndryshme të qytetit të Shkodrës, ku vlerësoi mbi të gjitha mikpritjen e besimtarëve në të gjitha xhamitë, kënaqësinë e takimit me ta, ndarjen e mendimeve, urimeve dhe lutjeve me besimtarë e shumtë në cepat e ndryshëm të xhamive të Shkodrës.

Në këtë mbrëmje të begatë, të cilën Myftiu e çmoi si “Mbrëmja përmbyllëse e një cikli të begatë në prag të natës së parë të teravisë të Ramazanit të sivjetshëm”. Ai iu drejtua të pranishmëve me disa këshilla rreth përsosjes së besimtarit në muajin e Madhërueshëm të Ramazanit në Kur’anin Famëlartë.

Myftiu theksoi se, interesimi që duhet të ketë muslimani për Kur’anin duhet të qëndrojë mbi çdo interesim që ai i jep çdo gjëje tjetër në jetën e tij të përditshme. Myftiu theksoi se, Kur’ani Famëlartë është udhëzimi hyjnor, që i tregon njeriut rrugën dhe mënyrën e të jetuarit me dinjitet e krenari, duke evituar ndalesat dhe çdo gjë të dëmshme në jetën e tij.

Ajetet kur’anore, ku Allahu i Madhëruar thotë në Kur’anin Famëlartë: “Atyre të cilëve ua kemi dhënë librin, e lexojnë ashtu siç e meriton në të vërtetë të lexohet!”, ku theksoi se të lexuarit e vërtetë të Kur’anit Famëlartë, është jo thjesht interesimi për nxjerrjen e saktë të texhividit, por praktimi me texhvid i Kur’anin Famëlartë në jetën e përditshme.

Myftiu solli në vëmendjen e besimtarëve edhe shprehjen e njohur të Hz. Enes ibn Malik, i cili thotë: “Ka prej atyre, që e lexojnë Kur’anin dhe Kur’ani i mallkon ata!”, dhe këtu solli shembuj të ndryshëm nga jeta e përditshme duke nxitur besimtarët drejt përsosjen së marrëdhënieve me Kur’anin Famëlartë.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë besimtarët dhe imamët, që iu përgjigjën këtij projekti duke gjallëruar xhamitë tona në këtë periudhë të begatë në prag të muajit të Madhërueshëm të Ramazanit dhe lutet me zemër, që të kemi një muaj të Ramazanit të mbushur plot mirësi dhe besim.

“RAMAZAN MUBAREK!” – ME URIMIN E KËTIJ MUAJI TË BEGATË SHPËRNDAHEN EDHE MATERIALET E RAMAZANIT

Paraditen e së xhumasë, më 28 shkurt 2025, Myftinia Shkodër përmes sektorit të rinisë organizoi aktivitetin: “Ramazan Mubarek!” duke shpërndarë për kalimtarët materiele të ndryshme për muajin e Begatë të Ramazanit.

Aktiviteti u zhvillua në sheshin bri xhamisë së Parrucës, ku kalimtarë të ndryshëm morën si dhuratë, librin “Ramazani, muaji i rimëkëmbjes”, broshurën “Një fjalë nga Hz. Muhammedi (a.s) për çdo ditë të agjërimit tënd..”, kalendarin e Ramazanit, gazetën Udha Islame, etj.

Myftinia Shkodër falënderon të rinjtë dhe të rejat, të cilët morën pjesë në këtë aktivitet me vlerë dhe dobi për njerëzit dhe i uron të gjithëve: Me zemër të mirë muajin e Begatë të Ramazanit. Agjërim të lehtë dhe të pranuar tek Allahu i Madhëruar!

VEPRIMTARI HUMANITARE NË PRAG TË MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT

Ditën e mërkurë, më 26 shkurt 2024, Myftinia Shkodër, në kuadër të muajit të Begatë të Ramazanit zhvilloi shpërndarjen e 90 pakove me ndihma ushqimore për anëtarët e shoqatës së Personave më Shikim të Kufizuar në Shkodër.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni në prani të medieve tha se: “Myftinia Shkodër në kuadër të muajit të Begatë të Ramazanit ka nisur shpërndarjen e ndihmave për shtresat në nevojë, të varfër dhe skamnor, të cilët zënë një hapësirë të veçantë gjatë këtij muaji dhe në shenjë humanizmi dhe solidariteti me ta”.

Teologu Halluni u shpreh se: “Ky gjest modest nuk është vetëm një ndihmë materiale, por mbi të gjitha një shenjë e kujdesit dhe vëmendjes sonë ndaj një komuniteti që meriton më shumë mbështetje dhe përfshirje”.

Ai falënderoi Zyrën e Çështjeve Fetare, pranë Ambasadës së Republikës Turqisë në vendin tonë, pikërisht atasheun e saj, Dr. Adem Gerdeliz, për dhurimin e këtyre pakove me ndihma të shpërndara për këtë shtresë në nevojë, nën organizimin e Myftinisë Shkodër.

Myftinia do të vazhdojë në prag dhe në ditët e muajit të Ramazanit, me veprimtari të tjera të shpërndarjes së ndihmave të ndryshme humanitare për familjet në nevojë, jetimët, etj.

MYFTINIA SHKODËR NË MBËSHTETJE TË SHTËPISË SË TË MOSHUARVE SHKODËR

Paraditen e së enjtes, më 27 shkurt 2025, në prag të muajit të Begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër dorëzoi në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, 30 pako ushqimore për banorët e kësaj Shtëpie të madhe.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Ervil Kuçi, njëkohësisht dhe përgjegjës i shërbimit social pranë Myftinisë, tha përpara medieve, se: Në prag të muajit të Madhërueshëm të Ramazanit, njëra prej përparësive të Myftinisë Shkodër, padyshim që është edhe fusha e bamirësisë dhe e kujdesit ndaj njerëzve në nevojë.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë, përmes projektin Shporta e Ushqimit të Fondacionit Bamirës Mbreti Selman, i kanë dhuruar Myftinisë Shkodër një kontingjent ndihmash prej 380 pakosh ushqimore, prej të cilave 30 pako i dorëzuam sot në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër. Ndërsa, pjesa tjetër e këtij kontingjenti do të shpërndahet në ditën në vijim sipas një kalendari dhe listash të njerëzve dhe shtresave të ndryshme në nevojë.

Teologu Kuçi, ndër të tjera theksoi se, muaji i Ramazanit nuk është vetëm muaj i agjërimit, por edhe muaj i solidaritetit dhe i përkrahjes, ku i njeriu i mundësive ndihmon vëllain e tij në nevojë.

Ndërsa, drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve, z. Fatjon Hoxha falënderoi Myftininë e Shkodrës dhe në veçanti Myftiun, Imam Muhamed B. Sytari, që nuk e harrojnë këtë Shtëpi të madhe, por gjithmonë e përkrahin me projekte dhe iniciativa të mira, duke iu gjendur pranë të moshuarve, të cilët jetojnë dhe kalojnë jetën e tyre së bashku.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë bamirësit dhe u bën thirrje të gjithëve të solidarizohen dhe të mbështesin me sa kanë mundësi njerëzit dhe shtresat në nevojë.

MEJTEPI IM... XHAMIA DRAÇIN

Pak histori:

- Xhamia Draçin, ndodhet në një prej lagjeve të vjetra të qytetit të Shkodrës.

- Përbëhet prej rreth 110 familje. Familjet më të njohura në Draçin janë: Paçrami, Dibra, Zekaj, Urza, Shema, Bajrami, Ademi, Dakaj, etj.

- Xhamia e re e lagjes Draçin, e ndërtuar mbi të njëjtin vakëf, ku ndodhej edhe më parë, është përuruar ditën e xhuma, më 19 korrik 2019.

- Në këtë xhami nga viti 2019 deri

të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, ditën e xhuma, më 31 janar 2025 zhvilloi takimin e radhës me nxënësit e mejtepit/kursit fetarë të xhamisë Draçin.

Në fillim, teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, zbatimin e programit mësimor të Myftinisë Shkodër, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesja znj. Emine Alushi, etj.

Në fund të takimit u zhvilluan pyetje dhe përgjigje rreth mësimeve fetare që marrin fëmijët gjatë këtij procesi arsimor dhe edukativ.

me sot kanë shërbyer imam dhe mësues të mejtepeve: Sadri Ujka, Ritvan Luzaku, Taksim Plori, Esmir Selimi, Ferid Rrilla, Gilman Kazazi dhe mësuesja aktuale, znj. Emine Alushi.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 5 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami, në periudha të ndryshme nga viti 2019 -2025 është rreth 80 nxënës dhe nxënëse.

Takimi me nxënësit:

Në vijim të vizitave dhe takimeve

Myftinia Shkodër ju uron:

Agjërim të lehtë dhe të pranuar!
Ramazan mubarek!

Kalendari i Ramazanit 1446/2025

Duaja: "**O Zoti im, Ti je Falës, e do faljen, më fal mua!**" | **Nata e Kadrit**, e mërkurë, 26 mars 2025
Falja e sabahut në xhami bëhet 20 minuta pas Imsakut (Syfyrit) | *Oraret janë referuar zonës së Shkodrës*

1 Ramazan	SYFYRI 4:41	IFTARI 17:39	1 Mars	11 Ramazan	SYFYRI 4:25	IFTARI 17:51	11 Mars	21 Ramazan	SYFYRI 4:07	IFTARI 18:02	21 Mars
2 Ramazan	SYFYRI 4:40	IFTARI 17:40	2 Mars	12 Ramazan	SYFYRI 4:23	IFTARI 17:52	12 Mars	22 Ramazan	SYFYRI 4:05	IFTARI 18:03	22 Mars
3 Ramazan	SYFYRI 4:38	IFTARI 17:41	3 Mars	13 Ramazan	SYFYRI 4:22	IFTARI 17:53	13 Mars	23 Ramazan	SYFYRI 4:04	IFTARI 18:04	23 Mars
4 Ramazan	SYFYRI 4:36	IFTARI 17:43	4 Mars	14 Ramazan	SYFYRI 4:20	IFTARI 17:54	14 Mars	24 Ramazan	SYFYRI 4:02	IFTARI 18:05	24 Mars
5 Ramazan	SYFYRI 4:35	IFTARI 17:44	5 Mars	15 Ramazan	SYFYRI 4:18	IFTARI 17:55	15 Mars	25 Ramazan	SYFYRI 4:00	IFTARI 18:06	25 Mars
6 Ramazan	SYFYRI 4:33	IFTARI 17:45	6 Mars	16 Ramazan	SYFYRI 4:16	IFTARI 17:56	16 Mars	26 Ramazan	SYFYRI 3:58	IFTARI 18:07	26 Mars
7 Ramazan	SYFYRI 4:32	IFTARI 17:46	7 Mars	17 Ramazan	SYFYRI 4:14	IFTARI 17:57	17 Mars	27 Ramazan	SYFYRI 3:56	IFTARI 18:08	27 Mars
8 Ramazan	SYFYRI 4:30	IFTARI 17:47	8 Mars	18 Ramazan	SYFYRI 4:13	IFTARI 17:58	18 Mars	28 Ramazan	SYFYRI 3:54	IFTARI 18:09	28 Mars
9 Ramazan	SYFYRI 4:28	IFTARI 17:48	9 Mars	19 Ramazan	SYFYRI 4:11	IFTARI 18:00	19 Mars	29 Ramazan	SYFYRI 3:52	IFTARI 18:10	29 Mars
10 Ramazan	SYFYRI 4:27	IFTARI 17:49	10 Mars	20 Ramazan	SYFYRI 4:09	IFTARI 18:01	20 Mars	1 Sheval	FITËR BAJRAMI	BAJRAMI FALET N Ë ORËN: 07:10	30 Mars

www.myftinia-shkoder.org
FB|YT: MYFTINIASHKODER1990

Botues: **Myftinia Shkodër**
Drejtues: **Imam Muhamed Sytari**

Kryeredaktor: **Lavdrim Hamja**

Tel / Fax: **+355 (0) 224 2081**
Nr. llogarie: **100054 UBA - Shkodër**

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek